



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.65 dt.08.05.1998

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.08.05.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës Kontroll Revizionit “Mbi rezultatet e kontrollit ekonomik financiar dhe tekniko – administrativ të kryer në Uzinën Metalike “Tirana” vëren se :

Puna në ruajtjen, dokumentimin, administrimin, qarkullimin e vlerave materiale e monetare, funksionimin e Këshillit Drejtues të uzinës dhe në lidhjen e kontratave nga ana e ndërmarrjes për dhënien me qera të objekteve subjekteve private është bërë me të meta dhe dobësi. Ka munguar organizimi, drejtimi si dhe kontrolli financiar ka qenë i dobët.

Përsa më sipër në mbështetje të nenit 14 të ligjit Nr.7572 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”

**VENDOSI**

- 1.Në mbështetje të ligjit Nr.7982, dt.13.07.1992 “Për funksionimin e ndërmarrjeve shtetërore” dhe Udhëzimit në zbatim të ligjit, të largohet nga detyra Drejtori i Uzinës Metalike “Tirana” Z.Admir Shameti për paaftësi në detyrë dhe veprime të parregullta në dokumentimin e administrimin e pasurisë së ndërmarrjes.
- 2.Të shkarkohen të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues për indiferentizëm të theksuar në përgjegjësitë që i ngarkon qenia e tyre si anëtarë të këtij këshilli.
- 3.Të emërohet Drejtor i Uzinës Metalike Tirana Z.Ali Zylfo.
- 4.Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi menjherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

